

Takimet e Mynihut 2024

Simpozium shkencor

Tryeza ekspertësh, punëtori (Workshop), rrjetëzime, bashkëpunime, nisma

<http://dija-ev.eu/#tm>

Dr. Eshref Januzaj

E-Mail: januzaj@dija-ev.eu

Më 29 dhe 30 nëntor 2024, në Mynih të Gjermanisë do të organizohen Takimet e Mynihut, një ngjarje e rëndësishme shkencore, e cila që do të mbledhë shkencëtarë dhe shkencëtarë shqiptarë dhe përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor nga shumë shtete.

Takimet e Mynihut dhe simpoziumi shkencor, të cilat organizohen për çdo vjet nga **Shoqëria e Akademikëve shqiptarë DIJA e.V. në Mynih** (Gjermani), janë një nismë, e filluar nga komuniteti akademik shqiptar në Mynih të Gjermanisë, për të krijuar një platformë promovuese për iniciativat shkencore/hulumtuese që synojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të komunitetit shqiptar të mërgatës dhe institucioneve gjegjëse në vendet amë.

Edhe këtë vit Takimet e Mynihut organizohen në bashkëpunim me **Institutin shkencor mbarëkombëtar Alb-Shkenca** dhe me mbështetje nga Shoqëria gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar GIZ dhe Qyteti i Mynihut (Gjermani).

Pjesëmarrës në këtë aktivitet do të jenë studiues nga shtete të ndryshme, përfshirë Gjermaninë, Austrinë, Francën, Suedinë, Norvegjinë, Mbretërinë e Bashkuar, SHBA-të, Holandën, Belgjikën, si dhe Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, duke krijuar një mundësi të mirë për shkëmbimin e njohurive dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e shkencës.

Në këtë ngjarje, të pranishëm do të jenë edhe përfaqësues të lartë të institucioneve nga Shqipëria dhe Kosova, ministritë e linjës përkatëse: *Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës.*

Përfaqësues diplomatik nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut në Gjermani do të jenë gjithashtu të pranishëm, duke siguruar mbështetje dhe promovuar rëndësinë e shkencës dhe inovacionit për zhvillimin e rajonit.

Drejtuues të **Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit** të Shqipërisë dhe të **Këshillit Kombëtar të Shkencës** të Kosovës, dy akademitë e Shkencave, e Shqipërisë dhe e Kosovës si dhe rektorët e universiteteve më të mëdha nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë gjithashtu të ftuar, duke theksuar rëndësinë e arsimit të lartë në zhvillimin e shkencës dhe inovacionit në rajon si dhe për të kontribuar me ekspertizën dhe njohuritë e tyre në diskutimet dhe panelet e ndryshme.

Takimet e Mynihut do të zhvillohen në disa seanca të rëndësishme, si tryeza të ekspertëve, panele diskutimesh, ligjërata të ftuara dhe simpozium shkencor. Do të trajtohen tema të ndryshme, duke

përfshirë rolin e gruas shqiptare në shkencë, si dhe mundësitë e bashkëpunimit mes shkencëtarëve nga Diaspora në kërkimin shkencor.

Një nga synimet kryesore të Takimeve të Mynihut 2024 është krijimi i një **Këshilli Shkencor të Diasporës**, i cili do të shërbejë si një urë lidhëse mes shkencëtarëve shqiptarë në Diasporë dhe institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Kjo iniciativë ka për qëllim të forcojë rrjetin e bashkëpunimit shkencor kombëtar dhe të lehtësojë identifikimin e mundësive për projekte shkencore të përbashkëta, si në mes të shkencëtarëve në Diasporë, ashtu edhe me kolegët në vendet e origjinës.

Temë e diskutimit do të jetë edhe mundësia e përfshirjes së shkencëtarëve shqiptarë në projekte shkencore të financuara nga Bashkimi Evropian, një mundësi që do të kontribuonte në avancimin e kërkimit shkencor dhe infrastrukturës kërkimore në shtetet tona.

Si ide konkrete për realizime afatshkurta do të elaborohen mundësitë për jetësimin e shkollave verore apo dimërore në universitetet e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut me ligjërues nga Diaspora. Po ashtu ofrimi i kurseve kompakte gjatë një viti akademik apo ligjërata serike gjatë një semestri.

Si planifikime afatgjata do të shqyrtohen mundësitë për mobilitet të studentëve dhe hulumtuesve në hapësirën akademike shqiptare, ngritja e studimeve të ekselencës si dhe konceptimi dhe zbatimi i projekteve shkencore të përbashkëta në rajon.

Takimet e Mynihut 2024 synojnë të ofrojnë një platformë për shkëmbimin e njohurive, forcimin e bashkëpunimit mes shkencëtarëve shqiptarë në Diasporë, nxitjen e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë në vendet tona si dhe për të thelluar lidhjet mes institucioneve dhe individëve që kontribuojnë në avancimin e shkencës dhe inovacionit, duke e bërë kështu një hap të rëndësishëm për të ardhmen e kërkimit shkencor shqiptar.

Mynih, më 20.11.2024

Dr. Eshref Januzaj

- Kryetar i Kryesisë,
Shoqëria e akademikëve shqiptarë - DIJA e.V., München, Gjermani
- Zëvendës drejtor i Përgjithshëm,
Instituti shkencor mbarëkombëtar "Alb-Shkenca".